

L I G J
Nr. 8927, datë 25.7.2002

PËR PREFEKTIN
(Ndryshuar me ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 114 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj përcakton misionin e prefektit, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark, cilësinë dhe kushtet për emërimin e tij dhe në mënyrë të veçantë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tij në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe me organet e qeverisjes vendore që veprojnë në qark.

Neni 2
Përkufizime

1. “Institucione qendrore në nivel vendor”, në kuptim të këtij ligji, janë të gjitha institucionet dhe strukturat e administratës publike të nivelit qendror të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe të institucioneve qendrore që ato kanë në kompetencë, si dhe personat juridikë që sipas ligjit drejtohen dhe administrohen prej tyre dhe që ushtrojnë veprimtarinë në njësitë administrative territoriale të qarkut.

Me institucion qendror në nivel vendor, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, nuk përfshihen institucionet dhe strukturat e Forcave të Armatosura, të Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të organeve të tjera në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj.

2. “Funksion publik”, sipas këtij ligji, nënkupton të qenit në administratën shtetërore, qendrore ose vendore.

3. “Akte normative”, në kuptim të këtij ligji, janë aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të tyre.

Neni 3
Cilësia

1. Prefekti është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në çdo qark.
2. Selia e prefektit vendoset në qytetin që është qendër e qarkut.

Neni 4
Emërimi dhe shkarkimi i prefektit

1. Prefekti emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit ose të Kryeministrit.

2. Prefekti duhet të ketë kryer arsimin e lartë, të ketë një përvojë pune jo më pak se 5 vjet në administratën publike dhe të mos jetë dënuar më parë, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi.

Neni 5
Papajtueshmëria e funksionit

Prefekti nuk mund të jetë anëtar i Këshillit të Ministrave. Funksioni i tij është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor e me çdo funksion tjetër publik, me qenien drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të shoqërive tregtare, me përjashtim të mësimdhënies dhe të veprimtarive shkencore.

Neni 6
Misioni i prefektit

Prefekti:

a) kujdeset, ndjek dhe merr masa për plotësimin nga të gjitha institucionet në nivel qarku të detyrimeve që ata kanë për të garantuar sovranitetin, rendin kushtetues dhe shëndetin publik;

b) mbikëqyr, kontrollon dhe bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor;

c) drejton veprimtarinë e strukturave administrative shtetërore, të cilat, me akte ligjore e nënligjore të veçanta, janë caktuar në varësinë e tij të drejtpërdrejtë;

ç) bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre me organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qark;

d) është i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qark, në përputhje me dispozitat e kreut III të këtij ligji. Prefekti ushtron kontroll financiar mbi këto organe në mënyrën dhe limitet e përcaktuara me ligj.

KREU II
MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT

Neni 7
Marrëdhëniet e prefektit me Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore

1. Prefekti për veprimtarinë e vet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave dhe i raporton Kryeministrit për detyrat që i janë ngarkuar.

2. Ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore vendosin lidhje të drejtpërdrejta me prefektin për probleme të veprimtarisë që ata drejtojnë.

3. Këshilli i Ministrave, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore dërgojnë rregullisht te prefekti të gjitha aktet që ata nxjerrin, të cilat, në përmbajtje të tyre,

caktojnë detyra në fushën e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor ose detyra për organet e administratës së qeverisjes vendore.

4. Prefekti, për veprimtarinë që mbulon, mund të paraqesë pranë ministrive projektakte për zgjidhjen e problemeve të veprimtarisë së tyre. Brenda një muaji ministri duhet t'i kthejë përgjigje prefektit për mënyrën dhe zgjidhjen e dhënë nga ana e tij.

5. Konfliktet që mund të lindin ndërmjet ministrit dhe prefektit zgjidhen nga Kryeministri.

Neni 8

Përgjegjësitë në marrëdhënie me institucionet qendrore në nivel vendor

Prefekti për kryerjen e funksioneve në marrëdhënie me institucionet qendrore në nivel vendor, ushtron përgjegjësitë e mëposhtme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj:

a) Kontrollon dhe u kërkon atyre marrjen e masave për zbatimin e programeve të Qeverisë, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit përkatës.

b) Ndhmon dhe u kërkon hartimin e planeve të zhvillimit dhe të projektbuxhetit vjetor, sipas procedurave të përcaktuara me ligj, dhe ua paraqet mendimet e tij ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

c) Kontrollon periodikisht dhe kërkon plotësimin e detyrave për zbatimin e buxhetit në sektorët që ata mbulojnë.

ç) Merr prej tyre të dhëna në përputhje me klasifikimin e përcaktuar nga institucioni qendror përkatës, me përjashtim të rasteve kur ndalohet me ligj ose me akte nënligjore.

Neni 9

Përgjegjësitë për emërim dhe shkarkim

1. Prefekti në përputhje me strukturën administrative të miratuar, sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji, emëron dhe largon, sipas procedurave të përcaktuara në ligj, punonjësit e vet të administratës, si dhe të strukturave administrative, të cilët, me akte ligjore e nënligjore të veçanta, i janë caktuar drejtpërdrejt atij.

2. Prefekti i propozon ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror përkatës emërimin dhe largimin e drejtuesve të institucioneve qendrore në nivel vendor që veprojnë në territorin e qarkut. Në rastin e emërimit propozohen jo më pak se dy kandidatura.

Neni 10

Detyra në lidhje me organet e Policisë së Shtetit

Prefekti bashkëpunon me organet e Policisë së Shtetit për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike në territorin e qarkut. Për këtë, ai kryen këto detyra:

a) Kërkon zbatimin e masave për ruajtjen e rendit, sipas përgjegjësiave e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Ai kërkon dhe merr rregullisht njoftim nga drejtori i policisë së qarkut për problemet e rendit.

b) Bashkërendon veprimtarinë dhe siguron mbështetjen e ndërsjellë të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të organeve të qeverisjes vendore, për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe për zbatimin e akteve të organeve të qeverisjes vendore.

Neni 11
Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes

Për strukturat e mbrojtjes, përveç detyrave të përcaktuara me akte të tjera ligjore e nënligjore, prefekti ka edhe këto detyra:

- a) Bashkërendon punën e degëve të mobilizimit, në nivel vendor, të reparteve ushtarake dhe organeve të qeverisjes vendore në qark për plotësimin e detyrave në fushën e mobilizimit ushtarak.
- b) Kontrollon marrjen e masave nga njësitë ushtarake për plotësimin e detyrave me karakter civil që u ngarkohen atyre nga organet përkatëse.
- c) Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin përkatës, u kërkon komandave të njësisë ushtarake në territorin e qarkut mbështetje për përballimin e detyrave me karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave emergjente.

Neni 12
Të drejta dhe detyra të tjera

Prefekti ka edhe këto të drejta dhe detyra:

- a) Jep të dhëna dhe mendime për zhvillimin ekonomiko-shoqëror në qark. Të dhënat dhe mendimet ua dërgon Këshillit të Ministrave, institucioneve qendrore dhe organeve të qeverisjes vendore.
- b) Kujdeset për nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve dhe të veprimtarive me institucione simotra të huaja, duke respektuar aktet ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie.
- c) Merr masa për parandalimin dhe shmangien e pasojave që vijnë nga situata emergjente ose nga fatkeqësi natyrore, duke plotësuar të gjitha detyrat që i ngarkohen me akte ligjore e nënligjore përkatëse.
- ç) Kur e çmon të nevojshme dhe kur i kërkohet, njofton ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore për veprimtarinë e kryer nga institucionet qendrore në nivel vendor, si dhe për shkallën e plotësimit të shërbimit në sektorët që ata mbulojnë.
- d) Në periudha të caktuara kohe, por jo më pak se dy herë në vit, njofton Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e kryer nga ai në plotësimin e detyrave të caktuara.
- dh) Drejton ose merr pjesë në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në qark, krahas funksionarëve të lartë të shtetit ose si përfaqësues i autorizuar i tyre, si dhe në veprimtaritë e organizuara nga organet e qeverisjes vendore, kur ftohet prej tyre.
- e) Çdo muaj, në bazë rrethi, shqyrton veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe bashkërendon punën ndërmjet tyre dhe organeve të qeverisjes vendore.
- ë) Ushtron dhe përgjegjësi e detyra të tjera që i ngarkohen me ligj ose me akte të veçanta të Këshillit të Ministrave.

KREU III
MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 13
Prefekti dhe organet e qeverisjes vendore

Ndërmjet prefektit dhe organeve të qeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie. Raportet e tyre vendosen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 14

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012)

1. Zbatimi i akteve të organeve të qeverisjes vendore bëhet në përputhje me pikën 6 të nenit 33 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

2. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore, në komuna, bashki dhe qark, nga prefekti bëhet pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurat e mëposhtme:

a) Çdo organ i qeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 7 ditëve nga data e shpalljes së tyre.

Marrja dijeni nga prefekti për aktin e depozituar nga organi i qeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit.

b) Për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

i) Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të qeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i qeverisjes vendore rishqyrton aktin. Vendimi i marrë nga organi i qeverisjes vendore pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti, depozitohet pranë prefektit me të njëjtën procedurë dhe afat si në shkronjën “a” të kësaj pike.

Në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, i drejtohet gjykatës administrative kompetente, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të këtij akti.

Prefekti ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti.

ii) Në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit organit të qeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën b(i) të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente.

iii) Në çastin kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, prefekti njofton organin e qeverisjes vendore.

Neni 15

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

(Zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012)

1. Prefekti verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organet e qeverisjes vendore, si dhe në organizmat që krijohen pranë tyre, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në gjashtë muaj.

2. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti vëren akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e tyre pranë gjykatës administrative kompetente.

Neni 16

Kontrolli i përgjegjësisë të deleguara

1. Prefekti kontrollon realizimin e funksioneve dhe të përgjegjësisë të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për to, si në rastin kur ato janë të parashikuara në ligj, ashtu edhe kur janë përcaktuar në marrëveshje të përbashkëta, ndërmjet një institucioni qendror dhe organit të qeverisjes vendore.

2. Prefekti kontrollon përdorimin e dhuratave dhe të kredive të dhëna që rrjedhin nga

marrëveshje të Qeverisë me organizma ndërkombëtarë.

Neni 17

Shqyrtimi i ankesave të shtetasve

1. Prefekti shqyrton ankesat e shtetasve për ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore.

Në këto raste ai u kërkon organeve të qeverisjes vendore depozitimin e aktit përkatës te prefekti, në rast se një gjë e tillë nuk është bërë më parë, ose zbaton procedurat e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.

2. Kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefekti vepron sipas procedurave të përcaktuara në shkronjën b(i) ose b(ii) të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

KREU IV

VENDIMMARRJA DHE ORGANIZIMI

Neni 18

Vendimmarrja

(Zëvendësuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012)

1. Në zbatim të përgjegjësive të tij, prefekti nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim, në përputhje me misionin e tij.

2. Aktet e prefektit bëhen të zbatueshme pasi u bëhen të njohura institucioneve ose personave të interesuar.

3. Në rastet kur lindin konflikte ndërmjet një ministrie ose drejtuesi të një institucioni shtetëror qendror jashtë sistemit të ministrive dhe prefektit për urdhrat ose udhëzimet që ai ka nxjerrë, zgjidhja bëhet sipas përcaktimeve të pikës 5 të nenit 7 të këtij ligji.

4. Për rastet e konflikteve të subjekteve që nuk përfshihen në pikën 3 të këtij neni dhe prefektit, palës së interesuar i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës administrative kompetente.

Neni 19

Administrata e prefektit

Për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e përgjegjësive të detyrave, prefekti ka administratën e vet. Struktura dhe detyrat e administratës së prefektit, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, miratohen nga Kryeministri.

Neni 20

Nënprefekti

1. Në mbështetje të veprimtarisë së prefektit dhe në përbërje të administratës caktohen nënprefektët, si rregull një nënprefekt në çdo rreth të qarkut, sipas ligjit nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”.

2. Nënprefekti emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, me propozimin e prefektit.

3. Nënprefekti, për veprimtarinë e vet në rrethin ku ai është emëruar, përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti.

4. Nënprefekti kryen këto detyra:

a) kontrollon dhe kërkon nga institucionet qendrore në nivel vendor, që veprojnë në rreth, marrjen e masave për plotësimin e detyrave, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre;

b) organizon takime periodike dhe, kur i kërkohet nga prefekti, bashkërendon punën me drejtuesit e institucioneve qendrore në nivel vendor për realizimin e detyrave të ngarkuara.

Me kërkesë të prefektit, nënprefekti mund të veprojë për të siguruar bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore për kryerjen e funksioneve të përbashkëta dhe të deleguara për to;

c) raporton sistematikisht te prefekti për punën që kryhet për plotësimin e detyrave nga administrata civile e shtetit në rreth;

ç) organizon punën për zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të prefektit;

d) drejton veprimtarinë e strukturave administrative në rreth që janë në varësi të drejtpërdrejtë të prefektit;

dh) i propozon prefektit masa për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të rrethit ku ushtron funksionet;

e) kryen dhe detyra të tjera që i ngarkohen nga prefekti, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore;

ë) shërbimet e tjera, që do të mbulohen nga nënprefekti, përcaktohen me akte nënligjore.

5. Nënprefekti, në plotësim të detyrave të caktuara në pikën 4 të këtij neni, lëshon dokumente të firmosura dhe të vulosura nga ai, sipas rregullave të përcaktuara nga prefekti.

Neni 21

Organi këshillues pranë prefektit

1. Pranë prefektit funksionon organi këshillues i tij. Përbërja e këtij organi caktohet me urdhër të prefektit.

2. Në organin këshillues, si rregull, marrin pjesë, me pëlqimin e tyre, kryetari i këshillit të qarkut, kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe drejtori i policisë së qarkut, drejtuesit dhe specialistët e institucioneve shtetërore, përfaqësues nga shoqëria civile, specialistët për fushat parësore të zhvillimit.

3. Numri i anëtarëve të organit këshillues është deri në 15 veta.

4. Organi këshillues mblidhet, si rregull, një herë në muaj, për probleme të përgjegjësisë dhe të detyrave të prefektit.

5. Rregullorja e funksionimit të organit këshillues miratohet nga vetë organi këshillues.

Neni 22

Shfuqizime

Ligji nr.7608, datë 22.9.1992 “Për prefekturat”, ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, shfuqizohet.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3439, datë 9.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**